



# BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

SHKURT 2020

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin shkurt 2020 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në te gjithë bashkite e vendit.

## 1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit shkurt 2020 zënë 13.35 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 147.92 /100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë (4.50/100.000 banorë). Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin shkurt 2020, me incidencë 1.08/10.000 banorë (18 raste të konfirmuara), dhe bashkia Korce ka raportuar vetëm 1 rast me Salmonelozë jotifoide. Të gjitha rastet janë konfirmuara në laboratorin e rrethit përkatës.

Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin shkurt 2020 në nivel kombëtar, përkatësisht me incidencë 1.56/10.000 banorë (26 raste të konfirmuara), dhe bashkia Diber ka raportuar vetëm 1 rast të konfirmuar me Shigelozë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin shkurt 2020

(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste Shkurt 2020	Incidenca shkurt 2019 (raste/100.000 banorë)
--	----------------------	---

Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	19	0.68
Shigelozë (Disenteri bacilare)	27	0.96
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	126	4.50
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	3970	141.78
Sëmundje diarreike në total	4142	147.92


## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1 Fruthi

Gjatë muajit shkurt 2020 janë testuar në total 3 raste me fruth, nga të cilat është konfirmuar 1 rast nga ana laboratorike. Ky rast i perket qytetit të Tiranës, në moshë pediatrike, i pavaksinuar dhe i shtruar në spital. Hetimi është kryer dhe janë vaksinuar të gjitha kontaktet e ngushta.

Ndërsa në muajin shkurt 2019 janë raportuar 120 raste të dyshuar me fruth nga të cilët 62 u konfirmuan nga ana laboratorike. Nga rastet e konfirmuara me laborator, 18 raste ose 29 % e tyre i përkasin grupmoshës nën 2 vjeç, ndjekur nga grupmosha 26-30 vjeç me 9 raste ose 14.5 %. Rastet e tjera janë të shpërndara në grupmoshat e tjera. 67.7% (42 raste) e rasteve të konfirmuara i përkasin rrethit të Tiranës, ndjekur nga Lezha me 19.4% (12 raste), Durrësi me 6.5% (4 raste) dhe Shkodra 3.25 (2 raste).

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara me fruth për muajin Shkurt 2019



## 2.2 Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit shkurt 2020 janë raportuar 9 raste me Tuberkuloz pulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 8 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara në të gjithë vendin në: Durres, Elbasan, Lezhe, Lushnje, Mat dhe Pogradec.

## 2.3. PFA, Paralize e paspecifikuar

Gjatë muajit shkurt bashkia Mat ka raportuar një rast suspekt PFA, femi i grup-moshes 5-9 vjec. U morën dy mostra rasti dhe nga ekzaminimi në Laboratorin e Virologjisë, ISHP dolën pozitiv. U krye investigimi i rasti dhe u morën masat përkatëse nga ana e NJVKSH Mat.

### 3. Zoonozat

Gjatë muajit shkurt 2020, është raportuar një rast i konfirmuar me antraks, 25-29 vjeç nga Gjirokastra dhe një rast i konfirmuar me Brucelozë, 15- 19 vjeç, nga Fieri. NJVKSH kanë kryer hetimin dhe kanë marrë masat përkatëse.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve zoonotike në shkurt 2020 (Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste shkurt 2020	Incidenca shkurt 2020 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	1	0.04
Brucelozë	1	0.04
Leptospirozë	0	0
Leishmaniaza viscerale	1	0.04
Leishmaniaza kutane	0	0

### 4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shkurt 2020 janë raportuar në total 5 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.16/100.000 banorë) nga të cilat, 1 rast është hepatit viral A i konfirmuar, 2 janë hepatit viral B dhe 2 raste hepatit viral as A as B. Në lidhje me hepatitin viral janë raportuar nga NJVKSH Berat, Devoll, Kucovë, Gjirokaster dhe Lushnjë.

### 5. HIV/AIDS

Në muajin shkurt 2020 janë kryer në total 88 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), 52 meshkuj dhe 36 femra. Nga këto ekzaminime, 16 prej tyre kanë rezultuar pozitive (9 meshkuj dhe 7 femra). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme, përkatësisht nga 21 deri 50 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Elbasan, Vore, Lac, Durrës dhe Korçë.

Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Spitali Infektiv, Spitali Amerikan, vullnetar, Laborator Privat dhe shoqata të ndryshme.

## 6. Grippi

Nga të dhënat e raportimit sipas Survejancës së Infeksioneve Akute Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme të sistemit ALERT, Survejancës Sentinel të Sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe Survejancës së Infeksioneve Respiratore Akute të Rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se në muajin shkurt 2020 aktiviteti i tyre paraqet rritje, ndërsa aktiviteti i gripit ishte i përhapur dhe me intensitet shumë të lartë me qarkullim të viruseve të tipit A dhe B, me mbizotërim të virusit të tipit A, nëntipi A/H1 pdm09

INSTITUTI I  
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI